

# BULETINI MUJOR

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

[www.ild.al](http://www.ild.al) | [info@ild.al](mailto:info@ild.al)



Inspektori i Lartë i  
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani  
[@ILD\\_Albania](https://twitter.com/ILD_Albania)

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PREZANTON PUNËN E ILD-SË  
NË TAKIMIN BILATERAL SHQYRTUES TË NEGOCIATAVE  
TË ANËTARËSIMIT NË BRUKSEL**





## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PREZANTON PUNËN E ILD-SË NË TAKIMIN BILATERAL SHQYRTUES TË NEGOCIATAVE TË ANËTARËSIMIT NË BRUKSEL

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani mori pjesë në takim bilateral Shqipëri-BE në Bruksel në kuadër të procesit të shqyrtimit (screening) mbi kapitullin 23, të negociatave të anëtarësimit.

Në prezantimin e tij “Mbi pavarësinë, paanshmërinë dhe llogaridhënien”, Z. Metani bëri një panoramë të plotë të sistemit të llogaridhënies së magistratëve në Shqipëri, pas miratimit të reformës në drejtësi, si dhe evidentoi kuadrin






regullator të sistemit llogaridhënës të magjistratëve, ecurinë e këtij procesi llogaridhënës, duke paraqitur edhe problematikat me të cilat institucionet e reja të drejtësisë dhe ILD specifikisht, u përballën në momentin e krijimit të tyre. “Problematikat po i sjell në këtë tavolinë, jo për të paraqitur ankesë apo në rastin më të keq për të justifikuar ndonjë situatë, por si një tregues i qartë i adresimit së këtyre problemeve me shpejtësi dhe efikasitet dhe për të treguar

përpara këtij paneli të nderuar se me gjithë vështirësitë, sistemi llogaridhënës së magjistratëve në Shqipëri po funksionon.

Tregues i qartë është interesi i publikut në lidhje me përdorimin e sistemit të ankesave ndaj gjyqtareve dhe prokurorëve, si dhe përdorimi gjerësisht i mekanizmit kushtetues dhe ligjor të kontrollit të punës së magjistratëve. “, tha Metani.

PETER LISY PPT (PRESENTATION)




REPUBLIC OF ALBANIA

---

## CONTENT

- I. Accountability
- II. Disciplinary System
- III. High Inspector of Justice (HIJ)
- IV. HIJ Budget, Administrative Structure and Capacities
- V. Disciplinary Investigations and Decisions (2020-2022)
  - V.I Complaints and Investigations (2020–2022)
  - V.II Disciplinary Proceedings (2020-2022)
  - V.III Thematic Inspections and Quality Promotion
- VI. Future Plans





Në prezantimin e Institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,

Z. Metani u fokusua mes të tjerash edhe tek plotësimi i kuadrit rregullator nëpërmjet akteve nënligjore, hetimi disiplinor, vendimet e ILD-së dhe procedimi disiplinor që prej nisjes së aktivitetit në Shkurt 2020 e më tej tek kontributi i ILD-së në rritjen e cilësisë së sistemit të drejtësisë, nëpërmjet zhvillimit të inspektimeve tematike. Prezantimi i ILD

-së u mbyll me paraqitjen e prioriteteve afatshkurtra dhe afatgjata të institucionit si vizion për të ardhmen.

“Këtë proces, apo një takim si ky i sotmi, personalisht e konsideroj rast unik në jetën profesionale të gjithkujt prej nesh. Unë besoj fort se ky proces negociatash me Bashkimin Evropian nuk është vetëm një proces politik dhe meritokratik, por mbart në vetvete një fuqi transformuese tek e cila unë besoj dhe që BE e

***“Unë besoj fort se ky proces negociatash me Bashkimin Evropian nuk është vetëm një proces politik dhe meritokratik, por mbart në vetvete një fuqi transformuese tek e cila unë besoj dhe që BE e transmeton natyrshëm tek vendet, të cilat aspirojnë për t’u bërë pjesë e saj apo më mirë, pjesë e vlerave të saj. Kjo sepse çmuj se drejtësia është standard e vlerë shoqërore dhe jo statistike.”***

PITER USY PPT (PRESENTATION)

REPUBLIC OF ALBANIA

### V.III Thematic Inspections and Quality Promotion

- 2 inspections are completed, and the inspection reports have been sent to the inspected institutions and reports are published on HIJ's official website. The third inspection will be completed within this year.

Results:

- real measurable effects – concrete responsibilities of magistrates, 4 proceedings against magistrates, 2 of which are dismissed by decision of Special Appel Chamber of Constitutional Court.
- prohibitive effects on the misuse of conditional release.
- quality in the delivery of justice.
- increasing the effectiveness in the implementation of the institution of setting personal security measures, for some criminal offenses.

ISCI VIDEO ROOM

transmeton natyrshëm tek vendet, të cilat aspirojnë për t'u bërë pjesë e saj apo më mirë, pjesë e vlerave të saj. Kjo sepse çmuj se drejtësia është standard e vlerë shoqërore dhe jo statistike.”


“Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë”, tha z. Metani, “fakti i funksionimit të sistemit llogaridhënës është një çështje thelbësore dhe me rëndësi të veçantë për të ardhmen, pasi një sistem së pari duhet të funksionojë dhe më pas të japë rezultate

dhe jo e kundërta. Dhe sistemi llogaridhënës po funksionon!

Rezultate ka por efektet e këtyre standardeve janë të shtrira në kohë. Krahas funksionimit, konstatohen edhe rezultate konkrete, si: procedimi i magjistratëve në rastet kur ata kryejnë akte që përbejnë shkelje disiplinore apo kujdesi i shtuar i magjistratëve kur aplikojnë institutet e së drejtës (rasti i lirimeve me kusht i të dënuarve të

***“Rezultate ka por efektet e këtyre standardeve janë të shtrira në kohë. Krahas funksionimit, konstatohen edhe rezultate konkrete, si: procedimi i magjistratëve në rastet kur ata kryejnë akte që përbejnë shkelje disiplinore apo kujdesi i shtuar i magjistratëve kur aplikojnë institutet e së drejtës (rasti i lirimeve me kusht i të dënuarve të rrezikshëm), etj., përsëri ka shumë punë për të bërë.”***


PETER LISY PPT (PRESENTATION)



REPUBLIC OF ALBANIA

### V.III Thematic Inspections and Quality Promotion

- Inspections - independent evaluation aimed at helping courts and prosecution offices to develop and achieve their goals, increase efficiency and quality
- HIJ aims to ensure that inspection process is constructive and useful
- **3 thematic inspections:**
  - On treatment of requests subject to "Conditional Release"
  - On the implementation of the General Prosecutor's general instruction regarding the relations between prosecutors and heads of prosecution offices
  - On the observance of the criteria for determining personal security measures for the criminal offense of "detention without permission and the production of weapons, explosives and ammunition"



rrezikshëm), etj., përsëri ka shumë punë për të bërë, jo vetëm për të bërë, që sistemi llogaridhënës të funksionojë tërësisht, në mënyrë permanente dhe me konsistencë.

Vlerat e respektimit të të drejtave të njeriut, të demokracisë dhe shtetit të së drejtës janë aset thelbësor i Bashkimit Evropian dhe sigurimi i tyre përbën përgjegjësi të përbashkët për të gjitha shtetet anëtare të tij. Megjithatë, mendoj se qasja ndaj tyre, duhet të shihet si një simbol, që na bashkon të gjithëve ne. Evropa para se të jetë një projekt politik

është një sistem vlerash njerëzore.

Pasi në fjalët e Jean Monnet, Bashkimi Evropian nuk ka për qëllim bashkimin e shteteve, por mbi të gjitha bashkimin e njerëzve, të cilët besojnë dhe jetojnë në sistemin e vlerave evropiane.”, u shpreh gjatë prezantimit Inspektori I Lartë i Drejtësisë Metani.

Në këtë takim paraqitën punën e tyre edhe drejtuesit e institucioneve të tjera të drejtësisë, pjesë e delegacionit të Shqipërisë në procesin e negociatave të anëtarësimit për kapitullin 23 “Gjyqësori dhe Liritë Themelore”.

***“Vlerat e respektimit të të drejtave të njeriut, të demokracisë dhe shtetit të së drejtës janë aset thelbësor i Bashkimit Evropian dhe sigurimi i tyre përbën përgjegjësi të përbashkët për të gjitha shtetet anëtare të tij.”***



### INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË TAKON MINISTRIN ITALIAN TË DREJTËSISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani po zhvillon një vizitë pune në Itali me ftesë të homologes, znj. Maria Rosaria Covelli, shefe e Inspektoratit Italian të Drejtësisë.

Gjatë vizitës, z. Metani zhvilloi një takim me ministrin e drejtësisë z. Carlo Nordio, me të cilin diskutoi mbi marrëdhëniet mes dy vendeve dhe bashkëpunimin e nisur nga ILD me Inspektoratin e Përgjithshëm të Ministrisë italiane të Drejtësisë, bazuar në

marrëveshje konkrete për shkëmbim eksperiencë.

Duke folur për negociatat e nisura të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, z. Metani nënvizoi se ky proces është sa politik aq edhe teknik dhe në këtë këndvështrim, kontributi i inspektoratit italian mbi standardet më të mira të punës me magjistratët është i çmuar për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

***Duke folur për negociatat e nisura të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, z. Metani nënvizoi se ky proces është sa politik aq edhe teknik dhe në këtë këndvështrim, kontributi i inspektoratit italian mbi standardet më të mira të punës me magjistratët është i çmuar për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.***

## SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE



### *Gjatë asistimit të ankuesve*

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut.

Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

*Gjatë muajit **Nënor 2022**, Sektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave ka pritur **21 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe **17 telefonata me qytetarë**, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.*





## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas ligjit dhe komunikon me kërkuar, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik. Kërkesa për informacion depozitohet nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: [info@ild.al](mailto:info@ild.al), si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit [amanta.jasa@ild.al](mailto:amanta.jasa@ild.al).

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

## SHIFRA MUJORE

*Gjatë muajit Nëntor, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 10 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuarit t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

## ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- \* mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- \* të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në [info@ild.al](mailto:info@ild.al) ose me postë

në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

- \* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin “Si pranohen ankesat”.

## NËNTORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Nëntor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **65 ankesa**, **62** nga të cilat janë paraqitur nga qytetarët dhe **3 ankesa** nga institucione.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Nëntor** 2022. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

### VERIFIKIME

- 14 vendime verifikimi, nga të cilat:
- 8 vendime verifikimi (Praktika të ILD-së);
- 6 vendime verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);

### HETIME DISIPLINORE

- 2 vendime për fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrat;
- 1 vendim për vazhdim të hetimit disiplinor (ish-KLD) për 1 magjistrat
- 2 vendime për mbyllje hetimi disiplinor për 4 magjistratë
- 2 kërkesë për procedim disiplinor për 2 magjistratë

### ARKIVIME

*176 vendime arkivimi nga 246 praktika të shqyrtuara:*

- 81 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (ILD);
- 31 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (dosje të mbartura nga ish KLD);

*64 vendime arkivimi pas verifikimit, nga të cilat :*


- 28 vendime arkivimi pas verifikimit (ILD);
- 36 vendime arkivimi pas verifikimit (dosje të mbartura nga ish KLD).

## SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit Nëntor, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, nga ankues, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre.

Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total ka bërë ka bërë 106 shpallje publike.



## ANKETA- DUAM MENDIMIN TUAJ PËR ILD-NË

*Komunikimi me publikun në funksion të transparencës mbetet një prioritet i vazhdueshëm për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Për të rritur komunikimin me qytetarët, Zyra e ILD ka hartuar dhe publikuar në faqen e internetit një Anketë, përmes së cilës kërkohet mendim mbi punën e deritanishme të institucionit. Anketa mund të plotësohet online ose fizikisht pranë ILD-së.*



## ILD VIJON PUNËN PËR ULJEN E NUMRIT TË DOSJEVE TË MBARTURA NGA INSTITUCIONE TË TJERA

Dy njësitë e inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve, si dhe sektorë të tjerë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, po punojnë me ritëm të lartë, për trajtimin e një numri të konsiderueshëm të ankesave e praktikave dokumentare, të cilat ILD i ka trashëguar nga institucione të tjera, që me nisjen e punës, më 1 Shkurt 2020.

Bëhet fjalë për 2104 dosje, një fond arkivor, i cili përbëhet nga ankesa të pa trajtuara, ankesa të trajtuara pjesërisht apo në faza fillestare të shqyrtimit të tyre, si dhe raste të hetuara pjesërisht

apo të papërfunduara nga ana e organeve të mëparshme, konkretisht Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Procedurat e ndjekura nga organet e mëparshme për trajtimin e këtyre praktikave dokumentare, për shkak të kompetencave të kufizuara e të ndara ndërmjet organeve të ndryshme gjatë periudhës kalimtare,

rezulton se janë zhvilluar në mënyrë jo të plotë dhe të pjesshme, për pasojë ato duhen rishikuar nga ILD.

Dosjet përmbajnë ankesa të depozituara në institucione ndër vite, kur ende nuk ishte ngritur Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Bashkë me ankesat e depozituara prej 1 Shkurtit 2020, kur nisi punën ILD, numri i ankesave të administruara në institucion është 4976.



**Procedurat e ndjekura nga organet e mëparshme për trajtimin e këtyre praktikave dokumentare, për shkak të kompetencave të kufizuara e të ndara ndërmjet organeve të ndryshme gjatë periudhës kalimtare, rezulton se janë zhvilluar në mënyrë jo të plotë dhe të pjesshme, për pasojë ato duhen rishikuar nga ILD.**





Për të shmangur kulturën e harresës e pandëshkueshmërisë, që do vinte edhe përmes parashkrimit të ankesave, pavarësisht burimeve jo të plota të inspektimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka kushtuar vëmendje praktikave të trajtuara pjesërisht nga ana e organeve të mëparshme, duke hartuar e miratuar një metodologji të posaçme pune, e cila është e publikuar në faqen zyrtare.

Kështu, ankesat apo praktikat dokumentare, trajtohen sipas një radhe përparësie të bazuar në kritere si: data e dorëzimit, faza e trajtimit nga ana e organeve të mëparshme, tipologjia ose urgjenca e trajtimit të ankesës, respektimi i parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe koha e nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e secilës praktikë dokumentare.

2104 praktikat e trashëguara trajtohen krahas ankesave të depozituara direkt në ILD, që prej Shkurtit 2020, në total 2872 ankesa. Ecuria javore e trajtimit të ankesave në të gjitha fazat që parashikon ligji, publikohet çdo të hënë në faqen zyrtare të ILD-së.



## NËNTOR 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD




## KONTAKT ILD

WEB: [ild.al](http://ild.al)

EMAIL: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)

ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,  
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)*